



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **25 prill 2024**, merr këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE
MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS 2024-2026

1. Me këtë vendim aprohet Plani i Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026.
2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani i Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi



Kryesuese i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	85/24
Nr. i fq. / Br. sh	-1-
Data: / Datum	25.04.2024
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 në lidhje me nenin 37 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **25 prill 2024**, merr këtë:

VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT LIDHUR ME THEMELIM E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit me numër të protokollit 01.Nr.04/22 i datës 14.01.2022 lidhur me themelimin e Komiteti për Politikë dhe Financa ashtu që në vend të z.Ilmi Azemi nga radhët e PDK-së emërohet z.Mensur Kasumi nga i njëjti subjekt politikë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

